



PROGRAMI

STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT PËR UJËRA NË KOMUNËN E SHTIMES PËR PERIUDHËN 2024-2028

Shtime 2024



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-2466/24 datë:22.01.2024



Npi – 01/43 datë: 31.01.2024

Duke u bazuar në nenet 12.2 shkronja (d), neni 17 shkronja (f), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Nenin 47 të Ligjit për Ujrat e Kosovës Nr. 04/L-147 “Programi për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave”; Udhëzimit Administrativ 19/2015, për Veprimet e Dëmshme të Ujërave; Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr. 07/2018 për Planifikimin dhe hartimin e dokumenteve Strategjike dhe planeve të veprimit. Planin Zhvillimor Komunal i miratuar më 31.10.2009 si dhe Planin Zhvillimor Urban i miratuar më 31.10.2009; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008, Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e mbajtur më: 31.01.2024, miratoi:

PROGRAMIN

STRATEGJIK DHE PLANIN E VEPRIMIT PËR UJËRA NË KOMUNËN E SHTIMES PËR PERIUDHËN 2024-2028

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Metodologjia.....	3
Vizioni.....	3
Misioni.....	3
I. Analiza e gjendjes.....	4
Të dhënat e përgjithshme.....	4
Popullsia.....	4
Hidrografia.....	5
Cilësia e ujit.....	6
Erozioni.....	6
Vërshimet.....	7
Ndotja e ujit.....	8
Degradimi i lumenjëve.....	8
Gjendja e mjedisit dhe biodiversiteti.....	9
Cilësia e ajrit.....	9
Ndotja e tokës.....	10
II. Analiza SWOT.....	11
III. Objektivat dhe Masat.....	12
IV. Plani i veprimit.....	17

Hyrje

Ky dokument është hartuar mbi bazën e Ligjit për Ujërat, përkatësisht neni, 47 Programi për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave, si dhe Udhëzimit Administrativ 19/2015, për Veprimet e Dëmshme të Ujërave. Strategjia për Ujërat në Komunën e Shtimes (2024-2027), analizon gjendjen e ujërave në Shtimes, si dhe vendos objektiva dhe veprime për mbrojtjen nga veprimet e dëmshme në territorin e komunës.

Strategjia për Ujërat në Komunën e Shtimes (2024-2027), ka katër (4) dimensione: i. mbrojtja e ujërave; ii. investimet publike në përmirësimin e infrastrukturës në ujëra; iii. përdorimi efikas i burimeve të ujit si dhe iv. Vetëdijësimi në mbrojtjen e ujërave.

Strategjia për Ujërat në Komunën e Shtimes (2024-2027) do të shërbejë si udhërrëfyes autoriteteve lokale në katër (4) fokuse: e para, në rritjen e kohezionit të politikave sektoriale komunale në funksion të mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujërave; e dyta, në forcimin e komunikimit dhe koordinimit në mes komunës dhe mekanizmave për mbrojtjen e ujërave; e treta, në integrimin e politikave dhe financimeve në këtë fushë dhe e katërta, në zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve dhe akterëve lokalë në funksion të mbrojtjes nga veprimet e dëmshme të ujërave.

Strategjia për Ujërat në Komunën e Shtimes (2024-2027), ka katër kapituj të veçantë I. Analiza e Gjendjes; II. SWOT Analiza; III. Objektivat dhe Masat dhe IV. Plani i Veprimit.

Metodologjia

Për zhvillimin e këtij projekti janë analizuar dhe aplikuar të dhëna empirike të analizës sasiore dhe cilësore. Gjithashtu janë përfshirë edhe të dhënat statistikore nga institucione e institute të ndryshme. Metodologjia e përdorur në këtë projekt kryesisht bazohet sipas të dhënave të verifikuara primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë të siguruar nga dokumente bazike të trajtuara nga institucionet lokale e qendrore, ndërsa për mbledhjen e të dhënave sekondare baza e analizës janë të dhënat nga hulumtimet, trajnimet dhe punëtoritë e ndryshme të organizuara për këto çështje të interesit publik, siç është trajtimi i ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura në komunën e Shtimes. Gjithashtu për të shtjelluar çështje specifike të natyrës të qeverisjes lokale do të shfrytëzohen edhe të dhëna statistikore e ekonomike të cilat do të përpunohen pas marrjes së të dhënave nga respondentë të ndryshëm.

Vizioni

Për më shumë siguri publike, duke parandaluar rreziqet nga vërshimet, e më tepër potencial të zhvillimit e mirëqenies duke u kujdesur për ujërat.

Misioni

Komuna e Shtimes është e përkushtuar të kujdeset për ujërat në territorin e saj, duke forcuar partneritetin me komunitetin lokal dhe bashkëpunimin me të gjitha autoritetet për menaxhim të ujërave.

I. Analiza e gjendjes

Të dhënat e përgjithshme:

Komuna e Shtimes ka një sipërfaqe prej 134km² apo 13.450,8ha, gjegjësisht 1,2 % të territorit të Kosovës. Shtrihet në pjesën Qendrore të Kosovës në koordinatat 42.43, 21.03. Kufizohet me komunat Lypjan në veri, Ferizaj në juglindje dhe Suharekën në perëndim. Gjatësia e pikave më të largëta në territorin e komunës është 19,8 km, në mes fshatrave Karaqicë në perëndim dhe Vojnoc në lindje. Gjerësia maksimale është 13,8 km në mes të komunave Pjetershticë në veri dhe, komunës katastrale Topillë-Devetak në jug. Komuna e Shtimes ka pozitë të mirë gjeografike ngase ka lidhje të mira dhe funksionale me qendrat përreth. Qendra administrative, qyteti i Shtimes, është 31km larg kryeqytetit të Kosovës - Prishtinës, 45km larg Prizrenit dhe 13km nga Ferizaj, kurse nga Aeroporti Ndërkombëtarë Adem Jashari është larg vetëm 24km¹.

Pozita e qendrës komunale ndaj vendbanimeve të komunës është e mirë dhe nuk i ndanë distanca të largëta, por as pengesa natyrore që do ta vështiroshin komunikimin. Në pozitën e saj gjeografike luginë e Caralevës ka rëndësi komunikative, jo vetëm për komunën, por edhe në hapësirë më të gjerë. Rruga e asfaltuar Pjetershticë-Komoran e ka shkurtuar lidhjen me pjesët tjera të Kosovës ka perëndimi. Komuna e Shtimes ka klimë të mesme kontinentale, me dimra mesatarisht të butë dhe me verë mesatarisht të nxehtë. Temperatura mesatare vjetore është 10.5 gradë Celsius. Muaji më i ftohtë është janari me temperaturë mesatare -9.gradë Celsius, ndërsa më i ngrohti është korriku me 29.4 gradë Celsius². Mesatarja vjetore e reshjeve në territorin e komunës është 633 mm/m². Sasia më e lartë e reshjeve është regjistruar në muajin maj 81.3 mm/m², ndërsa ajo më e ulët në muajin nëntor 41.7 mm/m². Mesatarja vjetore relative e lagështisë është 78.7%. Insolacioni vjetor është 2.153 orë. Vranësirat mesatare vjetore janë 52%. Shpejtësia mesatare vjetore e erës është 1.3 m/s në drejtim jug -perëndim dhe 2.8 m/s në drejtimin veri-perëndim. Pika më e ulët mbidetare në komunën e Shtimes është 545.7 m, ndërsa pika më e lartë mbidetare është 1,290 m. Rreth 54 % e sipërfaqës së komunës i takon lartësisë mbidetare deri në deri 700 m, rreth 27% e sipërfaqes së përgjithshme të komunës i takon lartësisë mbidetare 700-900 m, ndërsa që pjesa tjetër e sipërfaqës (rreth 17%) që përfshinë kryesisht zonat malore i takon lartësisë mbidetare mbi 900 m.

Popullsia

Komuna Shtimes ka popullsi në numër prej 27,324 banorësh, me 4.158 ekonomi familjare, me një dendësi populsi prej 203.91 banorësh/km² dhe me moshë mesatare 27.62 vjeç. Në bazë të të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, 13,850 banorë janë të gjinisë mashkullore (50.69%), ndërsa 13,474 janë të gjinisë femërore (49.31%). Struktura e popullsisë që jetojnë në vise rurale dhe urbane ka këtë pjesëmarrje: popullsia urbane me 7,255 banorë, ose 26.55% dhe popullsia rurale me 20,069 banorë, ose 73.45%.

Në komunën e Shtimes mesatarja e ekonomive familjare është 6.57 anëtarë për familje. Norma mesatare vjetore e shtimit (nataliteti), sipas vitit 2011, është 536 lindje, ose, shprehur në promilë, 19.61‰. Norma mesatare vjetore e vdekjeve (mortaliteti), sipas vitit 2011, është 85 vdekje, ose shprehur në promilë, 3.11‰. Pra, shtimi natyror për vit, në komunën e Shtimes, është 16.5‰.

¹ Plani Zhvillimor I komunës së Shtimes

² Instituti Hidrometeorologjik I Kosovës

Sipas vlerësimit të ASK-së për vitin 2021, Komuna e Shtimes kishte 27,449 banorë³, që shënon një rritje prej 0.4% të numrit të banorëve krahasuar me numrin e banorëve në regjistrimin e vitit 2011 (tabela 1). Sa i përket migrimit sipas të dhënave nga ASK, gjatë vitit 2021 në Komunën e Shtimes kishte një migrim prej 825 banorëve, përfshirë migrimet ndërkombëtare dhe ato kombëtare.

Të dhënat për popullsinë			
Regjistrimi ASK 2011		Vlerësimi ASK 2021	
Numri i popullatës	Numri i amvisërive	Numri i popullatës	Ngritje / zbritje %
27,324	4,158	27,449	+0.4%

Tab.1. Të dhënat mbi popullsinë

Hidrografia:

Lumi kryesor në teritorin e Komunës së Shtimes është lumi Shtimjanja. Ky lumë grumbullon edhe ujërat e lumit të Carralevës, Topillës dhe Mollopolcit. Sipërfaqja e pellgut të lumit Shtimjanja është 102 km², me një prurje vjetore 32.26 milion m³. Lumi Carraleva buron në malin Carraleva. Ky lumë së pari shfaqet pranë "Qafës së Duhlës" dhe vazhdon rrjedhën përgjatë luginës së ngushtë të Carralevës. Lugina zgjerohet në zonën nga fshati Belinc deri në Shtime. Ky lumë konsiderohet si një lumë malor, me gjerësi të shtratit të lumit 3-5m dhe deri në 7m përgjatë rrjedhës së poshtme. Thellësia mesatare e këtij lumi është 50cm dhe në disa pjesë deri në 1m. Gjatë stinëve të lagështa, uji derdhet në shtratin e lumit dhe përmbytë zonat përreth. Gjatë sezonit të verës përmbanë sasi shumë të vogël uji, rreth 40l/s. Lumë tjetër është ai i Topillës me gjatësi rreth 14,5 km prej tyre 12,9 km brenda territorit komunal. Ndërsa pjesa burimore rreth 1,7 km jashtë territorit komunal. Buron nga një lartësi mbidetare rreth 1200m. Lumi ka një rënie të theksuar prej burimi deri te gryka e tij.

Pozita e lumenjëve në raport me territorin e komunës është e mirë, ngase e përshkojnë pothuajse mes-për-mes territorin. Topografia e terrenit dhe kufiri komunal kanë mospërputhje në kuptim të drenimit të ujërave. Sipërfaqe jashtë territorit që drenojnë ujëra, në këtë komunë, ka mjaft raste, pellgu i lumit Carraleva ka rreth 17 km² jashtë komune. Lumi i Topillës i ka rreth 8 km² jashtë komune, njëkohësisht edhe lumi i Mollopolcit shtrinë një pjesë të pellgut e tij në komunën e Ferizajit. Nga kjo komunë janë disa lumenj që rrjedhin kah periferia e territorit komunal. Komuna kadastrale Pjetershticë dhe Karaçicë ujin e drenojnë kah pellgu i lumit Drenica. Kjo sipërfaqe është rreth 13 km², pjesa tjetër që është shumë më e vogël, ndodhet afër fshatit Mollopolc rreth 1,7 km² që rrjedhin në drejtim të lumit dhe vendbanimit Dremnjak. Edhe përroi i Godancit me pellgun e tij ka shtrirje periferike në raport me territorin komunal. Analiza e sipërfaqeve drenuese, ka rëndësi në vlerësimin e sasisë së ujërave, e sidomos në rastet kur janë të rrëmbyeshëm. Pjesa më e madhe e territorit është malore dhe lumenjtë janë të shpejtë, që ndikon edhe në rritjen e përqindjes së rrjedhjes së ujit. Mbulesa bimore është një stabilizator në rregullimin e rrjedhjes së ujit (regjimin lumor). Vegjetacioni një pjesë të ujit e shfrytëzon për jetën e tij, e rritë lagështinë në tokë, ngadalëson shkrirjen e borës. Në bazë të llogaritjeve të modulit të prurjes, shihet se nëpër komunën e Shtimes kalojnë izovijat e

³ Agjencia e Statistikave të Republikës së Kosovës

modulit të prurjes 4 dhe 6 l/sec / km². Kjo sasi e ujit këtë komunë e radhit në hapësirat relativisht të varfra me ujë (në pjesën e Dukagjinit moduli i prurjes lëvizë prej 10 deri në 40 l/sec/km² . Mesatarisht në këtë territor bien 90.182.000 m³ reshje që ushqejnë lumenjtë dhe ujërat nëntokësorë, kur i shtohen edhe pellgjet e lumit të Carralevës dhe Topillës, që një pjesë, e kanë jashtë territorit me rreth 25 km² dhe sasi të reshjeve me 16.825.000 m³. Sasia e përgjithshme del rreth 107 mil m³.

Ujërat nëntokësor në territorin e komunës së Shtimes mund të gjenden në aluvione dhe sedimente të Neogjenit⁴. Pjesa më e madhe ndodhet për gjatë lumit. Akuiferet bazohen në zallë dhe rrëzë në sedimentet neogjene, me qëndrueshmëri prej 5-15m me Kf=3.9 x 10-3cm/sec (Kf- Koeficienti i filtrimit) dhe debiti 2-10.01/sec. Rezervat e konsiderueshme të ujërave nëntokësore ndodhën në këto sediment. Një sasi e vogël uji gjendet në aluvionet e lumit Carraleva dhe në fshatin Pjetërshticë, zona e burimit të lumit Drenica. Sipas vlerësimeve të bëra bazuar në hartën hidro-gjeologjike, aluvionet dhe sedimentet ku ndodhën ujrat nëntokësore mbulojnë një sipërfaqe prej 43 km². Sipërfaqja e përgjithshme ujore e komunës përbëhet nga 96.6ha lumenjë, 6.18ha përrenjë dhe 2.61ha kanale ujore. Sipërfaqja totale e tokave ujore është 105.39ha ose 0.78% e territorit të përgjithshëm të komunës.

Cilësia e Ujit

Cilësia e ujit sipërfaqësor (të lumenjve) në territorin e komunës së Shtimes, monitorohet në dy pika monitoruese. Në Devetak dhe Vojnoc, të cilat ndodhën në lumin Shtimjanja, që i takon pellgut të Ibrit. Në këto pika monitoruese, monitorimi kryhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) dhe monitorohen 10 parametra fizik, 39 parametra kimik dhe 8 metale të rënda. Sipas vlerësimit të Agjensisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK), sa i përket parametrave fizik dhe kimik bazuar në të dhënat e monitorimit në njërën nga stacionet monitoruese (Devetak), cilësia e ujit nuk është e ndikuar shumë në faktoret e jashtëm nga aktivitetet njerëzore dhe cilësia e ujit është shumë e mirë, ndërsa në pikën e dytë monitoruese (Vojnoc) e cila ndodhet pas shkarkimeve të të gjitha ujërave urbane nga të gjitha fshatrat përreth dhe të vet qytetit të Shtimes, cilësia e ujit të këtij lumi është e dobët. Në këtë gjendje ka ndikuar shkarkimi i ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese, urbanizmi dhe bujqësia.⁵

Erozioni

Erozioni është njëra prej komponentëve mjaft me rëndësi për ta trajtuar ngase rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe begatitë e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Përsheptimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka ndikuar edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpërlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëqe, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të papërshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore.

⁴ Raporti monitories për gjendjen e ujërave në komunën e Shtimes(IËMRK-SDK)

Territori i komunës së Shtimes karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët përfshijnë sipërfaqen rreth 2445/ha, ose rreth 18% të territorit⁶. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën verilindore, përkatësisht në lokalitetet Davidovc, Rashincë, Muzeqinë, Vojnovc, Gjurkovc. Territorët me erozion të dobët përfshijnë sipërfaqe rreth 8038/ha ose 59.45 % të komunës së Shtimes. Shtrihen në lokalitetet Mollopolc, Petrovë, Reçak, Belinc, Dugë, Pjetershticë. Erozioni i mesëm vepron në sipërfaqe prej 1989/ha, ose 14.72 % të territorit të komunës. Ky lloj erozioni shtrihet në lokalitetet Shtime, Rancë, Llanisht, dhe pjesën veriperëndimore të Pjetërshticës. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Shtimes përfshijnë sipërfaqe prej 11.37 /ha ose 0.08 %. Këtë pjesëmarrje të vogël të këtij erozioni e hasim në pjesën verilindore të lokalitetit Mollopolc.

Vërshimet

Përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Sot përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezona të caktuara, të cilat janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellim dëme të konsiderueshme materiale⁷. Në botë ku përmbytjet janë të shpeshta punohet nën sloganin se përmbytjet nuk mund të parandalohen, por mund të menaxhohen. Në disa raste thuhet „të jetojmë me përmbytjet” që ka kuptimin se janë dukuri normale dhe të zakonshme. Me që janë të zakonshme edhe përgatitjet janë të zakonshme, me masa si janë thasët e rrës dhe pengesa tjera metalike e plastike, strehim, ushqim, ndihmë të parë mjekësore. Përmbytjet nuk mund të parandalohen prej faktit se uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e borës patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që ujit vërshues t’i krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë e pa pengesa.

Në komunën e Shtimes janë me rëndësi dy hapësira sa i përket përmbytjeve: e para është zona malore ku përrenjtë e vegjël gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë të rrëmbyeshëm dhe të bartin material që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe, dhe e dyta në zonën e rrafshët ku për shkak të mungesës së pjerrësisë së terrenit ujit të shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

Në këtë territor nuk janë të theksuara dëmet nga përmbytjet dhe janë të volitshme për menaxhim. Kjo arsyetohet me faktin se nuk ka lumenj të mëdhenj, përkatësisht sipërfaqja e pellgjeve është e vogël. Në qytetin e Shtimes lumi ka dalë nga kanali i tij dhe ka sjell dëme objekteve përreth. Kjo ka ndodhë për shkak të ngushtimit të kanalit dhe mbeturinave të ndryshme, që kur hasin në pengesa, shërbejnë si pengesa në rrjedhjen e ujit. Pas zgjerimit të kanalit të lumit dukshëm është rritë profili i tij tërthor dhe, ka kapacitet më të madh. Masat antierozive dhe, kujdesi me mbeturina japin efekte pozitive, ndërsa në pjesën e rrafshet kanalet e kullimit. Lumi i Carralevës ka kanal të cekët, prandaj, herë pas here del nga shtrati dhe përmbyt rrafshin aluvial të tij.⁸

⁶ Raport për gjendjen e ujrave në Kosovë 2020

⁷ Strategjia e ujërave në Kosovë(2021-2036)

Ndotja e ujit

Lumenjtë Topillë dhe Caralevë në pjesën burimore hyjnë në lumenjtë të kategorisë së parë (lum i pastër). Pas bashkimit të tyre formohet lumi Shtimjanja, i cili radhitet në lum me ndotje të kategorisë II-b. Shkarkimi i ujërave të zeza dhe industriale në lumin Shtimjanja rritë shkallën e ndotjes së lumit. Në pjesën e lumit Shtimjanja, që kalon nëpër qytetin e Shtimes shkarkohen ujërat e zeza pa ndonjë trajtim paraprak. Lumi Shtimjanja është me shkallë të ndotjes II-b nga dhe lumi Caralevës nga vendbanimi Caralevë e deri në grykë, e që derdhet në lumin Sitnica dhe pas daljes nga qyteti shkarkohen ujëra të zeza, ku shkalla e ndotjes rritet. Ndotja e ujit të lumit Shtimjanja është pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza të qytetit të Shtimes dhe fshatrave që shtrihen përgjatë lumit, si dhe, objekteve të ekonomive të vogla. Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit në Shtime. Mesatarisht çdo banor shkarkon $16.46 \text{ m}^3/\text{vit}$ ujëra të zeza. Vetëm Shtimja si qytezë me 9100 banorë shkarkon 4.74 l/s ose 149786 m^3 ujëra të zeza të pa trajtuara në lumë brenda vitit, pa llogaritur këtu objektet publike, tregtare hoteliere, industriale, si dhe, pa llogaritur vendbanimet tjera që shkarkojnë ujërat e zeza në rrjedhat lumore. Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja, ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore e bartë dhe e largon ndotjen. Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësi hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat, që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre, krijohen kushte të përshtatshme për jetesën e mikroorganizmave të ndryshëm, si dhe, parazitëve që, janë të dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën, që shtrihet përgjatë shtratit të lumit⁹. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave si të florës dhe faunës. Shkarkimi i mbeturinave të ngurta, është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe te vendbanimeve të komunës së Shtimes. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

Degradimi i lumenjëve

Në bazë të dhënave komunale nxjerrja e inerteve ka shkaktuar degradim të shtretërve të lumenjve dhe, si pasojë ka ardhur deri të ndërrimi i rrjedhës natyrore të lumit, pastaj ndotjen dhe shkatërrim e biosferës në shtratin e lumit dhe përreth tij. Pasojat e shfrytëzimit të inerteve në mënyrë të pa planifikuar në shtretërit e lumenjve shkaktojnë edhe vërshime në tokat bujqësore.

Vet rritja e bimëve të larta, pengesat natyrore dhe ato antropogjene kanë ndikuar negativisht në rrjedhën natyrore të lumit Shtimjanja, Caralevës, dhe Topillës. Sipërfaqja ujore rreth 100ha në komunën e Shtimes, në bazë të vrojtimeve dhe në bazë të analizave të bëra në GIS, kanë pësuar ndryshime, për shkak të uzurpimeve të shtratit të lumenjve dhe, për shkak të mbjelljes së bimëve të larta nga fermerët, që kanë pronat, përgjatë shtratit të lumit. Krijimi i fyteve të ngushta shkakton edhe vërshime të tokave bujqësore. Ndikimet negative janë prezent në të gjitha rrjedhjet ujore që kalojnë në vendbanime me hedhjen e mbeturinave të ngurta, ku depozitimi i tyre shkakton degradim dhe ndotje që ndikon negativisht në arealin biogeografik të shtratit të lumit. Hedhja e mbeturinave janë prezent në të gjithë lumenjtë e Komunës së Shtimes:

⁹ Raporti monitories mbi gjendjen e ujërave në komunën e Shtimes

Ujërrjedha e Lumit Pjetërshticë	Pjetërshticë
Ujë rrjedha e Lumit Carralevë	Carralevë, Belinc dhe Reçak
Ujë rrjedha e Lumit Godanc	Godanc i Epërm dhe Gjurovc
Ujë rrjedha e Lumit Topillë	Llanisht, Topillë, Devetak dhe Petrovë
Ujë rrjedha e Lumit Mollopolc	Mollopolc dhe Petrovë
Ujë rrjedha e Lumit Shtimjanja	Muzeqinë, Vojnovc, Shtime
Ujë rrjedha e Lumit Koshare	Gllavicë

Tab.2. Lokalitetet e ujërrjedhjet

Gjendja e mjedisit dhe biodiversiteti

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si pasojë e rritjes së vëllimit të ujërave të shkarkuara pa trajtimin adekuat fizik, kimik e biologjik. E gjithë kjo ndikon në rritjen e vlerave të parametrave fizik, kimik dhe mikrobiologjik në trupat ujorë. Vlerësohet që tejkalimi i këtyre parametrave është rezultat i shkarkimeve në trupin ujorë të ujërave nga aktivitetet e ndryshme prodhuese dhe industriale në këtë zonë. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve¹⁰, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore në territorin e Komunës së Shtimes. Burim i ndotjes së lumenjëve në komunën e Shtimes si u tha më lartë janë mbeturinat që hidhen në këta lumenjë dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumenjë pa ndonjë trajtim paraprak.

Cilësia e ajrit

Në komunën e Shtimes, nuk ka ndonjë stacion nacional apo lokal të monitorimit të cilësisë së ajrit, prandaj nuk ka të dhëna të cilave mund t'i referohemi për të vlerësuar cilësinë e ajrit në Shtime. Por nëse marrim për bazë të dhënat nga stacionet tjera dhe ngjashmëritë që ka komuna e Shtimes me lokalitetet tjera ku behët monitorimi i ajrit, vlerësohet dhe pritët që problemi kryesor të jetë ndotja me grimcat PM10 dhe PM 2.5¹¹.

Komuna e Shtimes, nuk ka ndonjë industri të zhvilluar që do të ishte burim i ndotjes së ajrit, përveç gurëthyesve dhe në disa vendbanime malore ku bëhet pjekja e gurit gëlqeror në furra klasike me anë të gomave të përdorura, andaj burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë ekonomitë familjare, institucionet publike që përdorin lëndë djegëse për ngrohje, transporti dhe operatorët e shfrytëzimit të gurit. Në komunën e Shtimes vlerësohet se janë 2903 ekonomi familjare që e përdorin drurin si lëndë djegëse. Konsumi vjetor i drurit vlerësohet të jetë 28.901 m³ dru. Mesatarja vjetore e sasisë së drurit të përdorur nga ekonomitë familjare për ngrohje është 9.33 m³.

Në ndërtesat publike të komunës së Shtimes në kuadër të pjesëmarrjes së burimeve energjetike që përdoren për ngrohje dominon druri me 2.184 m³ dhe 2500 l. naftë. Gjatë vitit 2018 dhe 2019, në ndërtesat publike të komunës së Shtimes nuk është përdorur thëngjilli për shkak të ndalimit të përdorimit të tij nga Ministria e Mjedisit, ndërsa ka filluar në raste sërish të përdoret si lëndë djegëse. Një kalkulim i përafërt i emetimeve totale vjetore të ndotësve të ajrit sipas sektorëve është prezantuar në tabelën si më poshtë. Nga

¹⁰ Plani strategjik për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtimes

¹¹ Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës

tabela shihet se burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë emetimet nga djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet dhe institucionet) si dhe trafiku.

Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sipas sektorëve dhe ndotësve ton/vit					
	Djegjet e vogla (amvisëria, shërbimet, ndërtesat publike)	Trafiku	Bujqësia	Gurëthyesit	Gjithsej
Grimcat e pluhurit PM10	322	61	23	23	429
Grimcat e pluhurit PM2.5	314	28	3	5	350
Oksidet e Azotit (NOX)	31	220	80	0	331
Dyoksidi i Sulfurit (SO2)	66	0,1	0	0	66
Monoksidi i Karbonit (CO)	1869	105	6	0	1980

Tab.3: Emetimet totale vjetore të emisioneve në ajër në komunën e Shtimes sektorëve dhe ndotësve ton/vit

Ndotja e tokës

Një ndër burimet kryesore të ndotjes së tokës janë edhe industritë kimike, përdorimi jo racional i pesticideve dhe plehrave jo minerale, ndotja e tokës me materie radioaktive, ndotja e tokës me metale toksike si dhe ndotja e tokës me mikro organizma patogjen. Gjithashtu edhe humbja e shtresës cilësore të tokës nga procese natyrore të erozionit si dhe nga aktivitetet e njeriut sikurse është prerja e pakontrolluar e pyjeve konsiderohet si ndër faktorët kryesor të degradimit të tokave. Në Kosovë ende nuk ka sistem të monitorimit të tokës (dheut). Në mungesë të të dhënave nga monitorimi i tokës/dheut, është e vështirë të bëhet një vlerësim i besueshëm. Megjithëkëtë ky problem është adresuar përmes projekteve specifike. Një nga këto projekte ka qenë projekti i financuar nga Bashkimi Evropian (BE) për studimin e tokës bujqësore në Kosovë (ALPS-Agriculture Land Pollution Survey). Qëllimi kryesor i projektit ka qenë të bëjë vlerësimin e ndotjes së tokës bujqësore. Në kuadër të projektit janë analizuar mostrat toke për 17 metale të rënda, mostra toke për treguesit e pjellorisë, mostra toke për përmbajtjen e ndotësve organik dhe mostra bime për metale të rënda. Vlerësimi i ndotjes së tokës ka qenë i orientuar në zonat potenciale të ndotjes si: zonat industriale, uji i ndotur dhe mbetjet, përmbajtjet, aktivitetet bujqësore.

Në kuadër të rezultateve kyçe të projektit thuhet se: përqendrimet e metaleve të rënda (Zn, Cr, Ni, Cd, Pb, Hg, Zn, Cu, si dhe Ni) janë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se nuk është identifikuar ndotja e të lashtave (perimeve, drithërave dhe frutave), nga metalet e rënda (në veçanti Cr, Ni, Pb, Zn,), prej mostrave të tokës për qëllime bujqësore.

Eksplotimi i resurseve minerare është një dukuri tjetër, e dëmtimit të tokës në komunën e Shtimes. Në bazë të të dhënave të Komisionit të Pavaruar të Minierave dhe Mineraleve, në

territorin e komunës së Shtimes operojnë 53 operatorë që si subjekt të veprimtarisë kanë eksploatimin e gurit dhe të rërës. Nga këta operatorë 25 operatorë prej tyre që kanë licenca për veprimtarinë e tyre dhe 9 operatorë që nuk kanë licenca për veprimtarinë e tyre¹². Faktorët tjerë që dëmtojnë cilësinë e tokave në Shtime janë edhe: ndërtimet e paplanifikuara, erozioni, dhe përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve.

II. Analiza SWOT

Analiza SËOT përmbanë komponente të cilat përbëjnë balancën e gjendjes reale të veprimit racional mbi zhvillimet lidhur me projektin. Në analizën e hulumtimit të aktiviteteve dhe të vepimit aksional, analiza SËOT shqyrton aspekte të diagnostifikimit dinamik sipa të cilave duhet merren në konsideratë zhvillimet lidhur „të priturat” dhe të „papriturat” në proces zhvillimi të projektit që mund ta ndihmojnë dhe ta pengojnë zhvillimet cilësore drejt harmonizimit dhe konsolidimit veprues lidhur me projektin tonë.

Pa u përkufizuar sipas një formati strikt konsiderojmë se „struktura” e SËOT analizës në komponente veta përmbanë si vijon:

Përparësitë:	Dobësitë:
• Vullneti i autoriteteve qendrore dhe lokale për përmirësim të gjendjes; • Infrastruktura ligjore e konsoliduar; • Shtrirja e operimit të mbledhjes së mbeturinave; • Zgjerimi i shtrirjes së rrjetit të ujërave të ndotura; • Vetëdijesimi i qytetarëve për menaxhim të ujit dhe derdhjes së ujërave të ndotura;	• Mungesë e burimeve njerëzore të kualifikuar dhe specializuara nga fusha e ujërave dhe ambientit; • Koordinimi i ulët ndërmjet autoriteteve përgjegjëse lidhur me menaxhimin e ujërave dhe ndotësve; • Mungesë e infrastrukturës lidhur me drenazhimin, kaskadat, kapërderdhjet dhe kullimin e sipërfaqeve; • Kufizimet buxhetore komunale në investimet në shtretërit e lumenjëve;
Rreziqet:	Mundësitë:
• Fytet e ngushta dhe infrastruktura e dobët e shtretërve të lumenjëve; • Kompanitë publike me kapacitetet të dobëta operacionale; • Mungesë koordinimi ndërmjet autoriteteve qendrore dhe lokale në reagimet ndaj rreziqeve të vërsimeve; • Kapacitete dhe paisje të kufizuara në ekipet e menaxhimit të	• Investimet komunale dhe nga niveli qendror në përmirësimin e infrastrukturës për shtretërit e lumenjëve; • Përditësimi i hartave të rreziqeve nga vëshimet nga autoritetet përkatëse; • Ri-shikimi i planeve operative emergjente, rritja e investimeve në përmirësimin e infrastrukturës si

¹² Burimi i informacionit: <http://opendata.cohu.org/sq/degradimi-mjedisit>

emergjencave; • Derdhjet e ujërave fekale në lumenjë;	dhe përkrahja me paisji e ekipeve të menaxhimit të emergjencave; • Investimet nga niveli qendrorë, donatorët dhe bashkëpunimi ndër komunal në ndërtimin e kolektorëve dhe impiantëve për trajtimin e ujëve të zeza;
--	--

III. Objektivat dhe Masat

Objektiva përgjithshme 1. Rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe mbrojtja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor ndaj aktiviteteve ndotëse

Përmes kësaj objekteve synojmë që të paraqesim synimet reale të identifikimit të ndotësve kryesorë të ujërave në komunën e Shtimes. Koncentrimi dhe derdhja e ujërave të ndotura ende bëhet sipas një sistemi klasik të derdhjes pa ju nënshtruar parametrave matëse sipas një metodologjie shkencore të trajtimit. Kësaj i shtohet edhe mungesa e infrastruktures të filtrimit apo kaskadimit të tyre në rrjedhje deri në shkarkim të plotë. Derdhja e ujërave vazhdon të bëhet pakufizim në sistemin e kanalizimit publik. Këto shkarkime në kanalizime publike bëhen nga amvisnia dhe ekonomitë familjare, ndërsa derdhjet e pakontrolluara në lum vazhdojnë nga industria e gurëthyesve dhe përpunuesve të rërës-zhavorit dhe sektorët ekonomik. Trajtimi i këtyre ujërave nënkupton edhe mobilizim të autoriteteve përgjegjëse lokale e qendrore, kompanive publike dhe të gjithë akterëve të cilët kanë përgjegjësi për të mbrojtur ambientin dhe ujërat në Kosovë e specifiku sht në komunën e Shtimes. Pa u përkufizuar në aktivitete e masa konkrete konsiderojmë se veprimet si në vijim do të ndikojnë në përmirësimin e kësaj gjendje:

Objektivi specifik 1.1. Rritja e investimeve infrastrukturore në mbrojtje të ujërave

Masat:

- 1.1.1. Të kryhet vlerësimi i ndikimit buxhetor në Kornize Afat-Mesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026, për nevojat e investimeve në mbrojtjen e lumenjëve;
- 1.1.2. Hartimi i projekteve dhe gjetja e mundësive të financimit nëpërmjet nivelit qendrorë dhe donatorëve në infrastrukturën e mbrojtjes së ujërave dhe parandalimin e rreziqeve nga vërshimet;
- 1.1.3. Identifikimi dhe analiza e plotë e burimeve ujore dhe gjendja e tyre nëpërmjet partneriteteve dhe donacioneve si dhe përfshirja e komuniteteve lokale në proces;
- 1.1.4. Të harmonizohen planet e investimeve dhe menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave në mes komunës dhe kompanive;

Objektivi specifik 1.2. Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ujërave të ndotura dhe parandalimi i degradimit të lumenjëve;

Komuna e Shtimes, ndërmarrja publike dhe operatorët privat nëpërmjet mbështetjes nga qeveria dhe donatorët duhet të hartojnë planin e rivitalizimit të sistemeve ekzistuese të kanalizimit publik dhe zgjerimin e tij. Si dhe të hartojnë planet afat-mesme dhe afatë-gjatë për vendosjen e kolektorëve dhe impiantit të trajtimit.

Konsiderohet se një përqindje e lartë në sistemin e kanalizimit publik funksionon me vështirësi teknike. Shahtet janë të dëmtura, pa kapak apo të papastruara prej kohësh. Poashtu edhe vetë derdhjet nga sistemi dalin në lumenjë. Nuk ka grumbullim të rrjetit të shtrirë e as impiantë të trajtimit.

Masat:

- 1.2.1. Në projeksionet buxhetore (2024-2026) të përfshihen në shpenzime kapitale dhe bashkë-financimet në infrastrukturën e rrjetit të kanlizimit dhe mbrojtjes së ujërave;
- 1.2.2. Hartimi i projektit për ndërtimin e kolektorit dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza;
- 1.2.3. Programi i financimit në kornizat buxhetore, gjetja e mbështetjes nga niveli qendrorë dhe donatorët;

Objektivi specifik 1.3. Zvogëlimi i ndotjes industriale të ujërave;

Sektori industrial është i koncentruar kryesisht në Parkun e Biznesit në rr.Komandant Kumanova, rr.Adem Jashari në fshatin Davidovc dhe Gurëthyesit përgjatë lumenjëve dhe rrjedhës së tyre në Grykën e Topillës dhe fshatrave Carralevë e Belinc. Ndonëse me kushtet dhe kriteret e përcaktuara nga autoritete lokale e qendrore, këto veprimtari industriale kanë licencat e tyre të operimit në hapsirë, ekziston rreziku i ndotësve të ujit nga veprimtaria e tyre. Operimi, ka ndikim direkt ngase, derdhjet nga Parku i Biznesit, afektojnë direkt pusët e furnizimit me ujë të pijshëm.

Pjesë e ndotësve të ujit dhe ajrit mund të konsiderohen edhe furrat e pjekjes së gurit gëlqerore. Për më tepër, në periudha të caktuara janë përdorur edhe lëndë djegëse si gommat, për këtë veprimtari. Përtej këtyre faktorëve, ndikim kanë edhe veprimtaritë tjera më të vogla që bëjnë punë industriale dhe derdhjen e mbetjeve e kanë qoftë në rrjetin e kanalizimeve apo direkt në ujëra.

Masat:

- 1.3.1. Identifikimi i ndotësve dhe kategorive të ndotjes nga industritë prodhuese, si dhe vlerësimi i ndikimit;
- 1.3.2. Vlerësimi i ndikimit të ujërave të zeza dhe industrial të Parkut të Biznesit në ujërat nëntokësor dhe shqyrtimi i ndrrimit të trasesë/largimi nga pusët e furnizimit me ujë të pijshëm;
- 1.3.3. Hartimi i projektit për ndërtimin e kolektorit dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për Parkun e Biznesit dhe gjetja mundësive të bashkëfinancimit me bizneset, nivelin qendrorë dhe donatorët;

Objektiva 2. Rritja e investimeve, mbikëqyrjes dhe ruajtjes së shtretërve të lumenjve

Presionet në ujëra vijnë kryesisht si rezultat i rritjes së vëllimit të ujërave nga niveli i të reshurave dhe faktorët klimatik. Si pasojë, mungesës së trajtimit të shtretëve të lumenjëve, derdhjeve të pa kontrolluara të ujëvave të zeza, derdhjes së mbeturinave dhe fyteve të ngushta, shkaktohen rreziqe për dalje nga shtretërit dhe vërshime. Referuar raporteve të konsultimeve publike dhe dëgjimeve buxhetore, nga kërkesat e qytetarëve del se ende nuk janë trajtuar në mënyrë konsistente mirëmbajtja e lumenjëve përgjatë rrjedhës së tyre. Vlerësohet që përballja me vërshimet në sezonën e shirave sipas të reshurave ka ndikuar në dëmtimin e pronës dhe sipërfaqeve me të mbjella në natyrë dhe serave me fidanishte. Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve ujore dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve¹³, ende mbetet një nga format e degradimit të resurseve ujore në territorin e Komunës së Shtimes. Burim i ndotjes së lumenjëve në komunën e Shtimes, janë mbeturinat që hidhen në këta lumenjë dhe derdhja e ujërave të zeza direkt në lumenjë pa ndonjë trajtim paraprak.

Objektivi specifik 2.1. Përmirësimi i infrastrukturës së shtretërve të lumenjëve

Nëpërmjet rritjes së investimeve në hapjen e shtratit dhe ndërtimit të kanaleve orientuese të ujërave nga lumenjtë parandalohen rreziqet nga vërshimet dhe ngritet siguria për qytetarët, pronat dhe të mbjellat e kulturat tjera bujqësore.

Është urgjente veprimi pro-aktiv i autoriteteve lokale lidhur me ndalimin e hudhjes dhe mbetjeve dhe mbeturinave inerte në lumenjë. Njëkohësisht edhe ndërveprimi me komunitetin lokal, në ruajtjen por edhe përmirësimin e gjendjes së lumenjëve. Rregullative përcakton masat dhe gjobat për personat të cilët hudhin mbeturina inerte dhe organike në lumë dhe shtratin e lumenjëve.

Megjithatë, për të siguruar qasje efikase dhe efektive, nevojiten një seri e masave dhe veprimeve për ta përmirësuar gjendjen, nisur nga: vlerësimi i gjendjes, reflektimi në planet operacionale emergjente, dhe intervenimet sistematike nëpërmjet investimeve publike.

Masat:

- 2.1.1. Zgjerimi i operimit të mbledhjes së mbeturinave, caktimi i deponive inerte, mbetjeve të kafshve (prerjet dhe të ngordhura) dhe zbatimi efikas i masave ndëshkuese për ndotësit;
- 2.1.2. Identifikimi i plotë i strukturës, pikave kritike të rrezikut dhe hartave të lumenjëve - vendosja në planin operativ emergjent dhe planet investimeve komunale;
- 2.1.3. Investimev në ndërtimin e mureve mbrojtëse, hapja e fyteve të ngushta, përmirësimi i devijimeve si dhe urave apo pengesave tjera rrethanore;
- 2.1.4. Investime në ndërtimin e kanaleve kulluese dhe të drenazhimit për të ulur nivelin e rrezikut nga vërshimit;
- 2.1.5. Investime në kanalet atmosferike dhe mirëmbahen ato ekzistuese;
- 2.1.6. Përfshirja e komunitetit për të ndërmarrë masa në parandalimin e rrëshqitjeve dhe pengesave në lumenjë;

¹³ Plan i strategjik për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Shtimes

Objektiva 3. Parandalimi i veprimeve të dëmshme ndaj ujit me qëllim rritjen e sigurtisë për furnizim për pije dhe përdorim efikas në prodhimet bujqësore

Qytetarët e komunës së Shtimes furnizohen me ujë të pijshëm nga pusët nëntokësore. Përmes sistemit të pompimit nga pikat të „Gështenjat“ dhe të Pishat, mbulohen nevojat e furnizimit me ujë të pijshëm. Edhe në vendbanime rurale janë ndërmarrë veprime për të bërë zgjidhje të furnizimit me ujë përmes pompimit. Pjesa tjetër e furnizimit me ujë kryesisht bëhet nga burimet vetanake përmes puseve të hapura nga pronarë individualë, si dhe nga burimet e ujit sipas rrjedhjeve nga krojet në vise malore sikurse në fshatrat malore: Pjetështicë, Carralevë, Zborc, Mollopolc, Reçak apo edhe fshatra tjera.

Edhe sa i përket përdorimit për bujqësi, aktualisht ujitja e sipërfaqeve bëhet në kushte individuale të fermerëve dhe bujqëve sipas kapaciteteve të kufizuara për ujitjen e sipërfaqeve. Sa i takon sistemeve të ujitjes së sipërfaqeve bujqësore nuk ka ndonjë infrastrukturë e cila mbulon ujitjen e sipërfaqeve bujqësore.

3.1. Parandalimi veprimeve të dëmshme në ujë dhe rritja e sigurtisë në furnizimin me ujë të pijshëm

Veprimet e dëmshme në ujë, kanë ndikim direkt në furnizimin me ujë të pijshëm, qoftë nëpërmjet sistemit të pompimit apo puseve të hapura, në veçanti në ujërat nëntoksore, apo nga kontaminimi i shkaktuar si pasojë e vëshimeve, apo ndotësve tjerë.

Përmbushja e kësaj objekte do ndikojë direkt në rritjen e sigurtisë në furnizimin me ujë të pijshëm, kujdesin ndaj shëndetit publik. Duke siguruar edhe masa të monitorimit, klorizimit dhe cilësive e vetive tjera kimike-bakteorologjike brenda paramentrave për furnizim cilësor dhe të sigurtë.

Masat:

- 3.1.1. Ndërtimi i mekanizmit të koordinimit sistematik me institucionet përkatëse për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm;
- 3.1.2. Hartimi i projektit së bashku me institucionet, kompaninë rajonale dhe autoritetet rregullative për ujërat për ndërtimin e fabrikës për trajtimin e ujit të pijshëm dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit;
- 3.1.3. Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, kontrolli i sistemit të furnizimit, përfshirë edhe rrjeti.

3.2. Përdorimi efikas i burimeve të ujit në bujqësi dhe shmangia e veprimeve të dëmshme;

Shfrytëzimi i ujit për bujqësi, prodhon efekte dy kahore: në njërin anë, bujqit duke krijuar rrjedha, apo diga rrisin rreziqet nga vërshimet, e në anën tjetër veprimet e dëmshme në ujë, rrisin rreziqet në prodhimet e kulturave bujqësore.

Edhe masat në përmirësimin e gjendjes duhet parë në dy prizme: e para, që të ulët ndotja nga derdhjet e prodhimeve nga industria e bujqësisë, përkatësisht fermentat, preparatet, pengimi i rrjedhës së lumenjëve, e në anën tjetër, të parashihen investime në pastrimin e lumenjëve dhe studimet e fizibilitetit për ndikimin e vendosjes së digave për shfrytëzim.

Masat:

- 3.2.1. Analiza e gjendjes mbi derdhjet e fermave në sistemin e kanalizimit dhe lumenjtë si dhe përdorimi i pesticideve dhe ndikimi në ujëra;
- 3.2.2. Identifikimi i rrjedhës së lumit/shtrirja në parcelat bujqësore dhe përdorimi i këtyre ujërave për prodhime;
- 3.2.3. Vlerësimi i ndikimit dhe përfshirja e komunitetit/përdoruesve të pronave/parcelave rreth shtrirjes së lumit në uljen e degradimit dhe parandalimin e rreziqeve;
- 3.2.4. Para secilit investim në diga, apo edhe në infrastrukturën e kanaleve të ujitjes të vlerësohet ndikimi në rreziqet nga vërshimet;

Objektiva 4. Ngritja e vetëdijes qytetare duke promovuar qasje miqësore që kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave

Përmes kësaj objektive synohet të arrihet një nivel komunikimi aktiv me komunitetet lokale në rritjen e informimit, njohurive si dhe rolit në parandalimin e veprimeve të dëmshme në ujë. Në këtë objektivë kryesore konsiderohet bashkëpunimi ndërmjet akterëve siç janë: mediat, shkollat, policia, ndërmarrjet rajonale të ujit dhe mbeturinave, shoqëria civile dhe vullnetarëve. Duke ju referuar kësaj objektive një bashkëveprim më i lartë i akterëve do të ndikonte reciprokisht në uljen e veprimeve të dëmshme në ujë, njëkohësisht në sigurinë më të madhe të përdorimit.

Masat:

- 4.1.1. Iniciativa të përbashkëta me shkollat në promovimin e ruajtjes së mjedisit nëpërmjet pastimit të ambientit;
- 4.1.2. Takime periodike me komunitetet lokale, lidhur me ndikimin dhe rolin e tyre në parandalimin e veprimeve të dëmshme në ujë;
- 4.1.3. Sigurimi i politikave favorizuese – subvençionimi i aktiviteteve në parandalimin e rreziqeve dhe kontributin publik;
- 4.1.4. Promovimi i aktiviteteve dhe rritja e prezantimit mediatik për shkaktarët dhe rreziqet nga vërshimet;



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi

IV. Plani i Veprimet

Objektiva përgjithshme	Objektiva specifike	Masat	Veprimet	Periudha e Implementimit	Përgjegjësia	Burimet e financimit
1. Rritja e nivelit të mbikëqyrjes dhe mbrojtja e ujërave sipërfaqësor dhe nëntokësor ndaj aktiviteteve ndotëse	1.1 Rritja e investimeve infrastrukturale në mbrojtje të ujërave	1.1.1. Të kryhet vlerësimi i ndikimit buxhetor në Kornize Afat-Mesme Buxhetore (KAB) 2024 – 2026, për nevojat e investimeve në mbrojtjen e lumenjëve;	1.1.1.1. Prioritetizimi i projekteve në fushën e mbrojtjes së ujërave; 1.1.1.2. Investime në eliminimin e plikave kritike të rrezikut; 1.1.1.3. Prioritetizimi i investimeve në ruajtjen e tokës nga ndotësit;	Cikli i planifikimit vjetor të Kornizes Afat-Mesme dhe Buxhetit (maj-shtator) 2024-2027	ZKF, DPUKGJP, DSHPJ; DZHEB	//
		1.1.2. Hartimi i projekteve dhe gjëta e mundësive të financimit nëpërmjet nivelit qendrorë dhe donatorëve në infrastrukturën e mbrojtjes së ujërave dhe parandalimin e rreziqeve nga vërshimet;	1.1.2.1. Analiza e gjendjes/ndikimit(ujrat vërshimet, ndotja, toka); 1.1.2.2. Nxjerrja e objektivave nga dokumentet/strategjitë komunale (parandalimi rreziqeve mbrojtja e tokës, vërshimeve); 1.1.2.3. Paraqitja e financimit/financimeve për projektin;	2024-2027	ZKF, DPUKGJP, DSHPJ; DZHEB	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët
		1.1.3. Identifikimi dhe analiza e plotë e burimeve ujore dhe gjendja e tyre nëpërmjet partneriteteve dhe donacioneve si dhe përfshirja e komuniteteve lokale në proces;	1.1.3.1. Shtirja hartografike e ujërave; 1.1.3.2. Promovimi i mbrojtje dhe investimeve; 1.1.3.3. Konsultimet me komunitetet lokale për burimet ujore.	2024-2027	DPUKGJP, DZHEB, Komunitetet lokale	Buxheti Komunal, përfshirja e shqërrisë civile dhe organizatave të specializuara dhe donatorëve

	1.1.4. Të harmonizohen planet e investimeve dhe menaxhimit të ujërave të zeza dhe mbeturinave në mes komunës dhe kompanive;	1.1.4.1. Takime periodike me kompanitë në harmonizim të planeve investive; 1.1.4.2. Të harmonizohen planet investive të ndotësve industrial me komunën në planifikimin e shtrirjes së rjetit të kanalizimit; 1.1.4.3. Hartimi i planeve të përbashkëta operacionale të menaxhimit të mbetjeve të kafshëve dhe inerte;	2024-2027	DSHPi, Kompanitë Rajonale	Buxheti Komunal, Investimet nga kompanitë rajonale dhe donacionet;
1.2 Përmirësimi dhe zgjerimi i rjetit të ujërave të ndotura dhe parandalimi i degradimit të lumenjëve	1.2.1. Në projektet buxhetore (2024-2026) të përshihen në shpenzime kapitale dhe bashkë-financimet në infrastrukturën e rjetit të kanalizimit dhe mbrojtjes së ujërave; 1.2.2. Rishikimi i projektit për ndërtimin e kolektorit dhe implantit për trajtimin e ujërave të zeza;	1.2.1.1. Të prioritetizohen investimet që prekin ndotjen e lumenjëve; 1.2.1.2. të prioritetizohen largimi i ndotjes nga tokat prodhuese; 1.2.1.3. të planifikohet zgjerimi i lumenjve dhe eliminimi i fytyrës të ngushta. 1.2.2.1. Vlerësimi i zbatimit të shtrirjes së kolektorit; 1.2.2.2. Finalizimi i projektit; 1.2.2.3. Komunikimi ndërkomunal për implantin;	2024-2027	ZKF, DPUKGJP, DSHPi; DZHEB, Donatorët	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët
1.3. Zvogëlimi i ndotjes industriale të ujërave;	1.3.1. Identifikimi i ndotësve dhe kategorive të ndotjes nga industritë prodhuese, si dhe vlerësimi i ndikimit;	1.3.1.1. Lista e prodhuesve në zonën ekonomike dhe prodhuesve sipas kategorive; 1.3.1.2. Vlerësimi i ndikimit në mjedis;	2024-2027	DPUKGJP, DSHPi; DZHEB, Bizneset	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët

		1.3.2. Vlerësimi i ndikimit të ujërave të zeza dhe industrial të Parkut të Biznesit në ujërat nëntokësor dhe shqyrtimi i ndrrimit të trasesë/largimi nga pusët e furnizimit me ujë të pijshëm;	1.3.2.1. Hartimi i projekteve të përbashkëta për menaxhimin e derdhjes së ujërave; 1.3.2.2. Vlerësimi i ndikimit të trasesë së kanalizimit në ujërat nën tokësorë - pusët e furnizimit me ujë;	2024-2027	DPUKGJP, DSHPi, DZHEB, Bizneset	Buxheti Komunal, planë investive të biznesve, aplikimi në financime (qeveri dhe donacione).
		1.3.3. Hartimi i projektit për ndërtimin e kolektorit dhe impiantit për trajtimin e ujërave të zeza për Parkun e Biznesit dhe gjetja mundësive të bashkëfinancimit me bizneset, nivelin qendrorë dhe donatorët;	1.3.3.1. Takimet me bizneset për hartimin e projektit; 1.3.3.2. Përfshirja e ekspertëve në gjetjen e zgjidhjeve; 1.3.3.3. aplikimi në fondet dhe donacione;	2024-2027	DPUKGJP, DSHPi, DZHEB, Bizneset	Buxheti Komunal, planë investive të biznesve, aplikimi në financime (qeveri dhe donacione).
2. Rritja e investimeve, mbikëqyrjes dhe ruajtjes së shtrëtërve të lumenjve	2.1. Përmirësimi i infrastrukturës së shtrëtërve të lumenjve	2.1.1. Zgjerimi i operimit të mbledhjes së mbeturinave, caktimi i deponive inerte, mbetjeve të kafshëve (prejjet dhe të ngordhura) dhe zbatimi efikas i masave ndëshkuese për ndotësit;	2.1.1.1. Vlerësimi i shtrirjes së mbledhjes së mbeturinave; 2.1.1.2. Faturimi nga komunave, regjistrimi i plotë në mbledhje; 2.1.1.3. Zgjerimi i menaxhimit/themelimi i ndërrmarjes publike lokale; 2.1.1.4. Caktimi i deponive të mbetjeve të kafshëve dhe inerte;	2024-2027	DSHPi, Kompanitë Rajonale, Komunitetet lokale.	Buxheti Komunal, Donacionet, Pagesat e deponimeve.
		2.1.2. Identifikimi i plotë i strukturës, pikave kritike të rrezikut dhe hartave të lumenjve - vendosja në planin operativ emergjent dhe planin investimeve komunale;	2.1.2.1. Verësimi i hartave nga Minsitria e Mjedisit; 2.1.2.2. Takimet me banorët; 2.1.2.3. Listimi i plotë i pikave të rrezikut në planin e emergjencave;	2024-2027	DSHPi, Zjarrefiksit, dhe operatorët tjerë të sigurisë.	Niveli qendror, niveli lokal, zjarrefiksit dhe mekanizmat tjerë të sigurisë (FSK, KFOR).

		2.1.3. Investimev në ndërtimin e mureve mbrojtëse, hapja e fytëve të ngushta, përmirësimi i devijimeve si dhe urave apo pengesave tjera rrethanore;	2.1.3.1. Vlerësimi i gjendjes kadastrale; 2.1.3.2. Fotografimi i gjendjes në teren; 2.1.3.3. planifikimi i investimeve;	2024-2027	ZKF, DPUKGJ, DSHP;	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
		2.1.4. Investime në ndërtimin e kanaleve kulluese dhe të drenazhimit për të ulur nivelin e rrezikut nga vërshimi;	2.1.4.1. Vlerësimi nga sektori i bujqësisë dhe kadastrit; 2.1.4.2. takimet me banorët; 2.1.4.3. investime në hapjen e kanaleve kulluese në pikat grumbulluese;	2024-2027	DSHP, Kompanitë Rajonale, Komunitetet lokale.	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
		2.1.5. Investime në kanalet atmosferike dhe miëmbahen ato ekzistuese;	2.1.5.1. Vlerësimi i lidhjeve të rrethit atmosferik në sistemin e kanalizimit; 2.1.5.2. Vlerësimi i gjendjes së rrjetit atmosferik; 2.1.5.3. Vlerësimi i ndikimit të investimeve (tretuareve në sistemin e kullimit);	2024-2027	DSHP, Kompanitë Rajonale operatorët ekonomik, Komunitetet lokale.	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
		2.1.6. Përfshirja e komunitetit për të ndërmarrë masa në parandalimin e rrëshqitjeve dhe pengesave në lumenjë;	2.1.6.1. Takimet informuese dhe konsultative me banorët; 2.1.6.2. përfshirja e aktorëve si bashkësitë fetare dhe këshillat lokale;	2024-2027	Komuna, Këshillat lokale, bashkësitë fetare.	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
3. Parandalimi i veprimeve të dëmshme ndaj ujit me qëllim rritjen e sigurisë për furnizim	3.1. Parandalimi veprimeve të dëmshme në ujë dhe rritja e sigurisë në furnizimin me ujë të pijshëm	3.1.1. Ndërtimi i mekanizmit të koordinimit sistematik me institucionet përkatëse për kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm;	3.1.1.1. Ndërtimi i sistemit të komunikimit me IKSHP, 3.1.1.2. Përfshirja/kontraktimi i kompanive të specializuara; 3.1.1.3. Vlerësimi i ndikimit nga cilësia e ulët e ujërave; 3.1.1.4. Vetëdijësimi dhe përdorimi i masave parandaluese;	2024-2027	Komuna, IKSHP, Komitetet lokale	Buxheti Komunal, Niveli qendror, IKSHP dhe Donatorët.

**për pije dhe
përdorim
efikas në
prodhimet
bujqësore**

për pije dhe përdorim efikas në prodhimet bujqësore		3.1.2. Koordinimi me kompaninë rajonale dhe autoritetet rregullative për ujërat furnizimin me ujë të pijshëm dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit;	3.1.2.1. Takime me kompanitë rajonale, qeverinë dhe donatorët për ndërtimin e fabrikës së ujërave; 3.1.2.2. Vizita në komuna që kanë investuar apo kanë planifikuar investime;		Komuna, Kompanite rajonale dh Autoritetet per menaxhim të ujërave	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.	
		3.1.3. Mirëmbajtja e vazhdueshme e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm, kontrolli i sistemit të furnizimit, përfshirë edhe rrjeti.	3.1.3.3. Kontrolli i furnizimit të institucioneve publike (shkollave); 3.1.3.4. Vlerësimi i gjendjes dhe zgjerimi i hidrantëve;	2024-2027	Komuna, Zjarëfikësat dh Autoritetet per menaxhim të ujërave	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.	
		3.2.1. Analiza e gjendjes mbi derdhjet e fermave në sistemin e kanalizimit dhe lumenjtë si dhe përdorimi i pesticideve dhe ndikimi në ujëra;	3.2.1.1. Lista e fermave dhe derdhja e mbetjeve; 3.2.1.2. Vlerësimi i nivelit të ndotjes, shtrirja në kanalizim	2024-2027	DZHEB	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.	
		3.2. Përdorimi efikas i burimeve të ujit në bujqësi dhe shmangia e veprimeve të dëmshme;	3.2.2. Identifikimi i rrjedhës së lumit/shtrirja në parcelat bujqësore dhe përdorimi i këtyre ujërave për prodhime;	3.2.2.1. Plani kadastral i shtrirjes se parcelave ne rrjedhen e lumit; 3.2.2.2. Vlerësimi i përdorimit të ujërave në prodhime;	2024-2027	DPUKGJP, DSHPI; DZHEB	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
			3.2.3. Vlerësimi i ndikimit dhe përfshirja e komunitetit/përdoruesve të pronave/parcelave rreth shtrirjes së lumit në ujën e degradimit dhe parandalimin e rreziqeve	3.2.3.1. Takimet me prodhuesit/bujqit; 3.2.3.2. ndikimi i shtrirjes se parceleve/freshqitjes; 3.2.3.3. Parandaimi i erozionit;	2024-2027	DPUKGJP, DSHPI; DZHEB Komuniteti lokal (fermeret)	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.

	3.2.4. Para secilit investim në diga, apo edhe në infrastrukturën e kanaleve të ujërës të vlerësohet ndikimi në rreziket nga vërshimet;	3.2.4.1. Ne planifikimin e investimeve të vlerësohet ndikimi në vërshime; 3.2.4.2. Të matet niveli historik i rritjes së ujërave;	2024-2027	DPUKGP, DSHP; DZHEB dhe Autoritete Menaxhuese të ujërave	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
	4.1.1. Iniciativa të përbashkëta me shkollat në promovimin e ruajtjes së mjedisit nëpërmjet pastimit të ambientit;	4.1.1.1. Krijimi i klubeve mjedisore në shkollat; 4.1.1.2. Prodhimi i materialeve vetedijesuese; 4.1.1.3. Iniciativat në pastim;	2024-2027	DKA, Këshillat e shkollave, Shoqëria civile	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
	4.1.2. Takime periodike me komunitetet lokale, lidhur me ndikimin dhe rolin e tyre në parandalimin e veprimeve të dëmshme në ujë;	4.1.2.1. Hartimi i kalendarit për takime me komunitetet lokale; 4.1.2.2. Ndertimi i agjendes vjetore; 4.1.2.3. Ndarja e roleve;	2024-2027	Drejtoritë përkatëse dhe Zyrtari për informim	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
4. Ngritja e vetëdijes qytetare duke promovuar qasje miqësore që kontribuojnë në ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave	4.1.3. Sigurimi i politikave favorizuese – subvencionimi i aktiviteteve në parandalimin e rrezikëve dhe kontributin publik	4.1.3.1. Vlerësimi i perkrabjes (afirmative) poentimi për kontribuesit; 4.1.3.2. Vlerësimi i masave për dëmtuesit;	2024-2027	DPUKGP, DSHP; DZHEB	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.
	4.1.4. Promovimi i aktiviteteve dhe rritja e prezantimit mediatic për shkaktarët dhe rreziket nga vërshimet;	4.1.4.1. Hartimi i planit të komunikimit; 4.1.4.2. Fushatat periodike vetedijesuese (zjarret, vërshimet, ndotsit); 4.1.4.3. Prodhimet mediatiche dhe videove promovuese;	2024-2027	Drejtoritë përkatëse dhe Zyrtari për informim	Buxheti Komunal, Niveli qendror dhe Donatorët.



KRYESUESI I KUVENDIT

Adnan Ademi